Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 13.11.2017
02-035/02-1004

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr o3/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/ 491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 2 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vitisë nr 01-016/775 të datës 28.07.2017 për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin aktiviteteve sportive dhe shërbimeve tjera të klubeve futbollistike që garojnë në Superligë dhe në Ligën e parë ,Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

# V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 3.165€ KLUBIT TË FUTBOLLIT "VITIA " NGA VITIA

### I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **3165€** me shkronja (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjet e pesë euro), Klubit të Futbollit " Vitia " nga Vitia në emër të mbështetjes financiare të këtij klubi për zhvillimin e garave në Ligen e parë të Republikës së Kosovës.

### II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 fondi burimor 21 , kategoria ekonomike subvencione dhe transfere ,programi buxhetor Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë .

Obligohet drejtori i KF "Vitia" nga Vitia që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të KF "Vitia" nga Vitia.

### III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

### IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Viti, më 12.12.2017
Vendimi u dorëzohet:

1. KF "Vitia" Vitia
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi